



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 557/2 Prot

Tiranë, më 21.07.2020

V E N D I M

Nr.74, datë 21.07.2020

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr. 30989, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** dhe mënyrën e zbatimit të tij”**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 557 prot., datë 22.6.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Doganier, Zyra e Operacioneve Doganore”, Dega Doganore Tre-Urat, Përmet, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatohet se, pas ristrukturimit të kryer në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast, me aktin nr. 561/48, datë 26.1.2018, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në DPD dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr.8096, datë 3.4.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm. Procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje

me rregullat që përcakton ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu siç referon pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Më pas, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 30989, datë 17.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësi *****, është transferuar në mënyrë të përkohshme, në pozicionin “Doganier në Zyrën e Operacioneve Doganore”, Dega Doganore Tre-Urat, Përmet (ku ai punon aktualisht), akt i cili, është kundërshtuar nga ky punonjës, pranë titullarit të institucionit, me pretendimin që ishte nja akt i dalë në kundërshtim me ligjin.

Në kushtet kur institucioni nuk ka reaguar ndaj ankesës dhe kur afati 6-mujor, si afat maksimal që përcakton legjislacioni në rastin e transferimeve të përkohshme ishte në përfundim, punonjësi ka parashtruar kërkesën për kthimin në vendin e mëparshëm të punës si “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, konstatohet që për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), pavarësisht rregullave të parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil, janë parashikuar rregulla të posaçme si në drejtim të llojeve të transferimeve dhe periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: “Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

Siç shihet, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (njëherësh ose e copëzuar) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Kjo do të thotë që, një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme diçka e tillë, pa patur ndonjë kufizim ligjor, duke ruajtur zbatimin e parimeve të proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, prandaj në këtë vështrim nuk mund të pranohet pretendimi i ngritur nga nëpunësi doganor se, transferimi i përkohshëm është i padrejtë për shkak se ai ka emërim definitiv pas ristrukturimit të institucionit.

Po kështu i pabazuar është edhe pretendimi tjetër se, transferimi i përkohshëm në një pozicion pune mbi 45 km larg vendbanimit të tij, vjen në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 48, pika 3/b, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Edhe për raste të tilla, Kodi Doganor, ka parashikuar rregulla të posaçme, dhe konkretisht, në pikën 7, shkronja “b”, të nenit 15, të këtij kodi, përcaktohet: “Transferimi mund të bëhet në një nga departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në degët doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen sipas ligjit, punonjës doganorë”.

Siç shihet, në këtë dispozitë është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 3/b, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës, “...nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil”. Sipas dispozitës në fjalë, një punonjës doganor mund të transferohet kudo në strukturat doganore apo në degët doganore (si në rastin konkret), pa patur ndonjë kufizim përse i përket distancës nga vendbanimi në vendin ku transferohet, mjafton që të jetë Degë Doganore apo struktura të tjera ku atashohen punonjës doganorë.

Më tej, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 30989, datë 17.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, rezulton se, ky transferim i përkohshëm është bërë për nevoja të institucionit (pika i, e dispozitës së sipërcituar) dhe meqë dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të transferimit të përkohshëm, kohëzgjatja nuk është shënuar në akt, pasi kjo presumohet.

Gjithashtu konstatohet që, akti është i ligjshëm, pasi ka dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, “Transferimi i përkohshëm”, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar, duke respektuar dhe kërkesën për ruajtjen e kategorisë dhe nivelit të pagës që ka patur në pozicionin e mëparshëm (kategoria IV-a).

Nga analiza e fakteve dhe të akteve ligjore si më sipër, arrihet në përfundimin që, transferimi i përkohshëm i punonjësit ***** , në pozicionin “Doganier, Zyra e

Operacioneve Doganore”, Dega Doganore Tre-Urat, Përmet, është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore që rregullojnë transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor.

Por, nga ana tjetër, është me vend të nënvizohet që, nga ana e organit kompetent që urdhëron këto lloj transferimesh dhe njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është vepruar në shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, në momentin që nuk është respektuar urdhërimi i ligjit, në shkronjën “c”, pika 7, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”*.

Në kushtet kur konstatohet që afati 6-mujor i transferimit të fundit, të nëpunësit ***** ka përfunduar, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, pa kushte.

Nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës *“Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”*, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.

2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha